



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM
Nr. 7 , datë 13.1.2021

PËR

MIRATIMIN E KUADRIT MAKROEKONOMIK E FISKAL
PËR PERIUDHËN 2022 - 2024

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 23 e 27 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e "Kuatrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2022 - 2024", si dhe lidhjen nr.1 "Treguesit kryesorë makroekonomikë" dhe lidhjet nr.2/1 e nr.2/2 "Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar", që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË

ANILA DENAJ



Republika e Shqipërisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2022-2024

Janar, 2021

Tabela e Përmbajtjes

Shkurtime.....	2
Hyrje.....	3
1. Zhvillimet më të fundit makroekonomike	4
2. Politikat Fiskale	6
3. Parashikimet e Treguesve Makroekonomik dhe Fiskal.....	9
Metodologjia e parashikimeve makroekonomike	9
Skenari makroekonomik e fiskal afat-mesëm.....	10
Lidhja Nr.1 "Treguesit kryesorë makroekonomikë".....	15
Lidhja Nr.2/1 "Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (në milionë Lekë)".....	16
Lidhja Nr.2/2 "Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (në përqindje të PBB)".....	17

Shkurtime

BB	Banka Botërore
BSH	Banka e Shqipërisë
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
INSTAT	Instituti i Statistikave
KM	Këshilli i Ministrave
KMF	Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal
LOB	Ligji Organik i Buxhetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
WEO	World Economic Outlook

Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2022 – 2024

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Hyrje

Kuadri Makroekonomik e Fiskal (KMF) për periudhën 2022-2024 është pjesë e Sistemit të Planifikimit të Integruar dhe përgatitet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. KMF ka për qëllim përcaktimin e përparësive strategjike të qeverisë. Ai projekton pritshmërinë makroekonomike në horizontin kohor afat-mesëm, si dhe parashikon nivelin e zërave të agreguar të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit. Ai përcakton synimet dhe objektivat e qeverisë në lidhje me treguesit kryesor të politikës fiskale si, balancën e përgjithshme fiskale (deficitin), huamarrjen, borxhin publik, balancën fiskale primare dhe atë korrente. KMF shërben si bazë për përcaktimin e tavaneve në fazën e parë të procesit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2022 – 2024 në nivel ministrie.


KMF miratohet nga Këshilli i Ministrave në muajin janar të çdo viti, dhe mund të jetë sërish subjekt rishikimi dhe përditësimi përgjatë vitit, përpara finalizimit të PBA dhe të tavaneve për shpenzimet.

KMF përmban dy komponentë kryesore: (i) parashikimet për treguesit kryesorë makroekonomik të cilët paraqesin pritshmërinë ekonomike për vitin aktual dhe tre vitet e ardhshme dhe (ii) parashikimet dhe objektivat për treguesit fiskal të cilët paraqesin burimet e pritshme në dispozicion të qeverisë për vitet 2022–2024 dhe shpërndarjen e tyre për këtë periudhë sipas buxhetit të konsoliduar. Këto komponentë paraqiten në mënyrë tabelore në fund të këtij dokumenti, përkatësisht Lidhja Nr.1; Lidhja Nr.2/1; dhe Lidhja Nr.2/2.

1. Zhvillimet më të fundit makroekonomike

Ritmi i rritjes ekonomike gjatë viteve të fundit ka treguar një trend pozitiv zhvillimi që është pasqyruar në një sërë parametrash makroekonomikë në vend. Megjithatë ekonomia shqiptare përjetoj dy goditje të forta brenda një harku kohor të shkurtër që përfshin tremujorin e katërt të vitit 2019 dhe vitin 2020, veçanërisht në tremujorin e dytë dhe të tretë të tij. Në muajin nëntor të vitit 2019, vendi u godit nga një tërmet tepër i fortë që solli dëme në njerëz dhe në ekonomi, ndërsa në muajin mars të vitit 2020 pandemia e COVID-19 u përhap edhe në Shqipëri, masat e ndërmarra ndaj së cilës, impaktuan ndjeshëm aktivitetin ekonomik në vend. Viti 2019 shënoi rritje ekonomike prej 2.2 përqind, krahasuar me rritjen prej 4.1 përqind të një viti më parë, si pasojë e faktorëve të paqëndrueshëm apo të përkohshëm përgjatë vitit, por edhe si pasojë e goditjes nga tërmeti.

Përgjatë vitit 2020 ekonomia globale u përball me vazhdimin e përhapjes së pandemisë Covid-19 dhe me masat shtrënguese të ndërmarra nga autoritetet publike për frenimin e përhapjes. Në Shqipëri, qeveria vendosi kufizime të lëvizjes së lirë që prej muajit mars, për të parandaluar përhapjen e mëtejshme të pandemisë në vend. Shqipëria është veçanërisht e ekspozuar ndaj tkurrjes ekonomike prej pandemisë për shkak se mbështetet fort nga sektori i



turizmit dhe për shkak të marrëdhënieve të saj intensive me disa ekonomi të BE-së të prekura rëndë nga pandemia. Sipas vlerësimeve më të fundit nga INSTAT, PBB reale u tkurr me 2.34 përqind në terma vjetorë në tremujorin e parë, duke u pasuar nga një rënie më e thellë prej -10.20 përqind në tremujorin e dytë dhe nga statistikat e fundit të publikuara nga INSTAT, në tremujorin e tretë, rënia është zbutur në shifrën -3.47 përqind krahasuar me tremujorët respektivë të vitit 2019. Ndërsa në terma nëntëmujor për vitin 2020, ekonomia ka pësuar rënie me 5.52 përqind kundrejt së njëjtës periudhë të 2019.

Sipas optikës së kërkesës agregate, rritja përgjatë vitit 2019 u gjenerua nga konsumi final si dhe nga kërkesa e brëndshme. Në nëntëmujorin e parë të vitit 2020, vlerësohet se të gjithë komponentët e kërkesës agregate kanë pësuar rënie të fortë. Pasojat e masave shtrënguese për frenimin e përhapjes së pandemisë, kanë sjellë tkurrje të eksporteve të mallrave dhe shërbimeve, konsumit familjar dhe investimeve totale në ekonomi. Ndërkohë, sa i takon investimeve në ekonomi, rënie kanë pasur vetëm ato private, ndërsa investimet publike (duke përfshirë këtu edhe investimet për ri-ndërtimin pas tërmetit) kanë pasur rritje të konsiderueshme. Këto kanë shërbyer edhe si një prej “amortizuesve” të goditjes së fortë negative gjatë vitit 2020.

Konsumi final për nëntëmujorin 2020 ka shënuar një rënie prej 3.4 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë të 2019, me një kontribut negativ në rritjen e PBB-së prej rreth 4.3 pikë përqindje. Formimi i

Kapitalit Fiks Bruto (investimet totale) ka shënuar një rënie prej 7.4 përqind, me kontribut negativ në rritjen ekonomike prej rreth 2.4 pikë përqindje. Kështu, kërkesa e brendëshme agregate ka pasur një tkurrje për nëntëmujorin prej 4.2 përqind, e një kontribut negativ në rritjen e PBB-së prej rreth 6.7 pikë përqindje. Eksportet e mallrave dhe shërbimeve, sipas vlerësimeve të INSTAT, gjatë nëntëmujorit të vitit 2020 janë tkurrur në mënyrë drastike me rreth 29.6 përqind. Por ndërkohë, duke qenë se edhe tkurrja e importeve të mallrave dhe shërbimeve ka qenë po ashtu tepër e fortë, si dhe në reflektim të peshës së lartë që importet kanë në ekonominë tonë, ka rezultuar në një rritje të kërkesës së huaj neto (ngushtim të deficitit midis eksporteve dhe importeve) krahasuar me një vit më parë me rreth 6.6 përqind, e rrjedhimisht duke dhënë një kontribut pozitiv në rritjen e PBB-së prej rreth 1.2 pikë përqindje.

Nga pikëpamja e ofertës agregate, dy sektorët të cilët kanë pësuar rritje përgjatë periudhës nëntëmujore të viti 2020, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë: “Bujqësia” me rritje prej 1.8 përqind dhe kontribut pozitiv prej 0.3 pikë përqindje, si dhe “Aktivitete të pasurive të paluajtshme” me rritje prej 5.9 përqind dhe kontribut pozitiv prej 0.4 pikë përqindje. Sektorët e tjerë kanë pësuar rënie në rendin vijues, ku: “Tregtia me shumicë dhe pakicë” është ulur me 15 përqind, dhe kontribut negativ prej 2.4 pikë përqindje; “Aktivitete shkencore dhe profesionale” me rënie prej 14.4 përqind dhe kontribut prej -0.9; “Arte, argëtim dhe çlodhje” me rënie prej 10.8 përqind dhe kontribut prej -0.2; “Industria” me rënie prej 5.4 përqind dhe kontribut prej -0.7 pikë përqindje; etj.

Dinamika në tregun e punës ka reflektuar përgjithësisht atë të aktivitetit ekonomik. Ndërkohë që viti 2019 rezultoi me një reduktim të mëtejshëm të shkallës së papunësisë me një nivel mesatar për gjithë vitin prej 12 përqind (për grupmoshën 15-64 vjeç), nëntëmujori i 2020 regjistroi një përkeqësim të konsiderueshëm të këtij treguesi në gjysmën e parë të vitit dhe më pas një rikuperim në tremujorin e tretë. Referuar anketës tremujore të forces së punës nga INSTAT, norma e papunësisë (për grupmoshën 15-64 vjeç) rregjistroi nivelin prej 11.9 përqind në tremujorin e parë, 12.5 përqind në të dytin dhe ra sërish në 12.1 përqind në T3-2020. Norma mesatare e papunësisë për nëntëmujorin e 2020 ishte 12.2 përqind, duke qëndruar pothuajse në të njëjtin nivel prej 12.1 përqind të nëntëmujorit të 2019. Ndërkohë, për grupmoshën 15 vjeç e sipër, norma e papunësisë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2020 regjistroi nivelin prej 11.6 përqind, me një rritje prej vetëm 0.2 pikë përqindje nga tremujori i tretë i 2019.

Bazuar në statistikat e bilancit të pagesave të BSH, bilanci i pagesave (BP) për vitin 2019, shënoi rënie kundrejt një viti më parë duke arritur vlerën -77.6 milion euro, nga 371.4 milion euro në 2018. Ndërsa për nëntëmujorin e parë të vitit 2020, Bilanci i Pagesave regjistroi balancë positive prej 797.3 milion euro, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ku shënonte balancë negative prej -4.8 milion euro. Deficiti i llogarisë korrente vlerësohet në rreth 805.5 milionë euro, i zgjeruar në terma vjetorë me rreth 62 milionë euro (ose 8.4%). Brenda llogarisë korrente, balanca e llogarisë së shërbimeve të lidhura përgjithësisht me Turizmin u ngushtua në vlerën +731.7 milionë euro, ose 55.3% më pak krahasuar me +1.636.7 milionë euro në të njëjtën periudhë të një vitit më parë. Ndërsa Remitancat për periudhën nëntëmujore të vitit 2020 shënuan rënie në vlerën +470.4 milionë euro, krahasuar me +520.0 milionë euro krahasuar me periudhën respektive të një viti më parë. Në nëntëmujorin e parë të vitit 2020, llogaria financiare dhe kapitale u zgjerua në +1.528 milionë euro krahasuar me +800 milionë euro në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ky zgjerim i balancës së llogarisë financiare ishte rrjedhje e


rritjes së fortë të flukseve hyrëse financiare, kryesisht huamarrje shtetërore (Eurobondi, kreditë në formën e mbeshtetjeve buxhetore nga insitucionet financiare ndërkombëtare, etj.), ndërkohë që Investimet e huaja direkte shënuan vlerën +739.4 milionë euro ose 11.1% më pak krahasuar me +831.6 milionë euro në nëntëmujorin e parë 2019.

Inflacioni mesatar përgjatë vitit 2019 ishte 1.4 përqind, nga 2 përqind që ishte një vit më parë. Ndërsa inflacioni mesatar për periudhën janar – nëntor të vitit 2020 është 1.7 përqind. Kursi i këmbimit të Lekut kundrejt valutave kryesore ka qëndruar përgjithësisht mjaft stabil. Kursi mesatar LEK/EURO për janar-nëntor 2020 ishte 123.8 nga 123 që ishte mesatarisht gjatë vitit 2019. Ndërsa kursi mesatar LEK/USD për janar-nëntor 2020 ishte 109.3 nga 109.9 që ishte mesatarisht gjatë vitit 2019.

2. Politikat Fiskale

Pas një stimuli të lartë, të domosdoshëm dhe njëkohësisht të paevitueshëm gjatë vitit 2020 me qëllim amortizmin e goditjeve negative (tërmeti dhe sidomos pandemia), politika fiskale për periudhën afatmesme 2022-2024 do të ri-orientohet sërish drejt konsolidimit fiskal, ndërkohë që siguron një nivel investimesh publike prej mesatarisht rreth 4.8 përqind të PBB në vit (vetëm nga qeveria qendrore). Konsolidimi fiskal dhe reduktimi i borxhit publik është thelbësor për uljen e risqeve makroekonomike, të cilat pengojnë rritjen ekonomike dhe shkaktojnë paqëndrueshmëri makroekonomike. Objektivat e politikës fiskale në KMF 2022-2024 janë në përputhje të plotë me parimet dhe rregullat fiskale të Ligjit Organik të Buxhetit (shih kuadratin në faqen 8).

Ky kuadër fiskal synon një deficit fiskal të përgjithshëm prej 2.9 përqind të PBB-së për 2022, nga 6.5 përqind i programuar për vitin 2021; nivel prej 2.3 përqind të PBB në 2023; dhe 2 përqind në vitin 2024. Njëkohësisht, si rrjedhojë e dy goditjeve të njëpasnjëshme fillimisht nga tërmeti dhe më pas shumë më fort nga pandemia Covid-19, balanca primare pritet të



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

shënojë vlera lehtësisht negative edhe për vitin 2022, në rreth 0.1 përqind, ndonëse me përmirësim të fortë nga niveli negativ prej 3.9 përqind që pritet për 2021, ndërkohë që targetohet në vijimësi rikthimi në vlera pozitive që prej vitit 2023 me 0.6 përqind dhe 1.1 përqind në vitin 2024.

Lidhur me balancën primare, i cili është një parametër shumë i rëndësishëm i qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike, së fundmi (Korrik 2020) u shtua edhe një rregull i ri fiskal në LOB, në linjë edhe me rekomandimet e KE dhe me parimet kryesore të “aquis” të BE, i cili bën të detyrueshëm ligjërisht tashmë që duke filluar që prej vitit buxhetor 2023 e në vijim balanca primare faktike nuk mund të rezultojë

negative, pra duhet të jetë së paku e balancuar ose pozitive (suficit primar). Ky target i parametrin të balancës primare buxhetore do të përbëjë tashmë dhe në vijimësi objektivin kryesor operativ të politikës fiskale për të materializuar synimin e një trajktore vijimësisht rënëse të borxhit publik, pra duke synuar konsolidim të vijueshëm fiskal me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë së financave publike si një fundament kyç i stabilitetit makroekonomik dhe mbarë-vajtjes së ekonomisë së vendit. Më konkretisht, duke marrë të mirëqëna supozimet dhe projeksionet e tjera të këtij Kuadri aktual, respektimi në mënyrë të përvitshme i këtij objektivi (rregulli fiskal) të parametrin të balancës primare, pritet të çojë në një reduktim të nivelit të borxhit publik neto rreth nivelit prej 68 përqind të PBB deri në vitin 2025 nga rreth 78.6 përqind që pritet të rezultojë në 2021.

PARIMET DHE RREGULLAT FISKALE

Në përputhje të plotë me obligimet që rrjedhin prej ligjit organik të buxhetit (LOB) nr.9936/2008, të ndryshuar, KMF 2022-2024 materializon parimet dhe rregullat fiskale të mëposhtme:

1. Në çdo ligj vjetor të buxhetit, fillestar apo të rishikuar, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, raporti i borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli i borxhit të arrijë dhe qëndrojë poshtë nivelit 45 përqind të Produktit të Brendshëm Bruto;

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, KMF 2022-2024 **targeton çdo vit një nivel të borxhit publik total në përqindje të PBB më të ulët se sa niveli i vitit pararendës.**

2. Vlera e Produktit të Brendshëm Bruto, nominale në lekë, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto për vitet buxhetore që planifikohen dhe për vitin pararendës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera respektive e parashikuar ose vlerësuar në raportin “Perspektiva ekonomike botërore” (Eorld Economic Outlook), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në kohën kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend. Kjo dokumentohet qartësisht në relacionin shoqëruar të ligjit vjetor të buxhetit;

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, KMF 2022-2024 **bazohet në projeksionet e mëposhtme të PBB nominale, të cilat paraqiten në mënyrë krahasimore kundrejt projeksioneve më të fundit të FMN. Në këtë rast, sipas shënimit të bërë në WEO më të fundit të publikuar në muajin Tetor 2020, ku thuhet se “Projeksionet WEO u përgatitën përpara misionit të parë të Monitorimit Pas Programit që përfundoi në 28 shtator dhe kështu nuk pasqyrojnë përditësimet e bëra gjatë misionit”, për referencë janë marrë shifrat e PBB nominale të misionit më të fundit të FMN (misioni i Monitorimit Pas Programit, i kryer në Shtator 2020).**

Parashikimet e PBB nominale të MFE dhe FMN	(në miliardë Lekë)						
	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
MFE	1,635.7	1,679.3	1,572.3	1,682.6	1,803.0	1,928.8	2,050.8
FMN	1,635.7	1,678.4	1,572.5	1,682.8	1,803.8	1,929.9	2,052.3
Diferenca MFE - FMN (Diferenca e vlerave të parashikuara duhet të jetë jo më e madhe se zero)	0.0	0.9	-0.2	-0.2	-0.8	-1.1	-1.5

3. Në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përfshihet një kontingjencë e veçantë, prej jo më pak se 0.7 për qind e shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, Kuadri 2022-2024 përfshin për çdo vit në një zë të veçantë të tij, emërtuar “Kontingjencë për luhatjet e normave të interesit, etj.” një kontingjencë prej mbi 0.7 përqind e shpenzimeve totale.

4. Të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor. Në rastet e arkëtimit ato përdoren, jo më pak se 50 përqind, për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër për investime publike. Pas arritjes së nivelit të borxhit publik, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 4/1 të Ligjit Organik të Buxhetit nr.9936/2008, të ndryshuar, përdorimi i të ardhurave të arkëtuara nga privatizimet përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, Kuadri 2022-2024 **nuk përfshin të hyra nga privatizimet e mundshme.**

5. Masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal – “rregulli i artë”) të LOB, deficitit i targetuar në Kuadrin 2022-2024 **është çdo vit më i ulët se sa shpenzimet kapitale të planifikuara.** Rrjedhimisht, balanca korrente e targetuar është pozitive prej mesatarisht 2.4 përqind të PBB në çdo vit të programuar.

6. Në çdo vit buxhetor që prej vitit 2023 e në vijim, balanca primare faktike nuk mund të rezultojë negative, pra duhet të jetë të paktën e balancuar ose pozitive (suficit primar).

Në përputhje me këtë dispozitë, Kuadri 2022-2024 **targeton një balancë primare pozitive në vitin 2023 me 0.6 përqind dhe 1.1 përqind në vitin 2024.**

1. Linku për raportin “WEO” – <https://www.imf.org/en/Publications/WEO/Issues/2020/09/30/world-economic-outlook-october-2020>

3. Parashikimet e Treguesve Makroekonomik dhe Fiskal

Metodologjia e parashikimeve makroekonomike

Parashikimi i treguesve makroekonomik afatmesëm dhe i tërësisë së elementëve përbërës të kuadrit makroekonomik është bazuar kryesisht në metodat modeluese dhe analitike të programimit financiar. Skenari bazë i kuadrit makroekonomik, mbështetet në linjën aktuale të politikave makroekonomike, në linjën aktuale të politikave e reformave ekonomiko-strukturore qeveritare, në sjelljen dhe në bashkëveprimin racional të agjentëve ekonomikë brënda kontureve të ambientit të brendshëm e të jashtëm makroekonomik, i cili vlerësohet si më i mundshmi për periudhën afatmesme në vijim. Në kryerjen e këtyre parashikimeve janë ngritur një set supozimesh bazë, si dhe janë përdorur një set i gjerë të dhënash statistikore makroekonomike të gjeneruara prej institucioneve si, INSTAT, BSH, MFE, FMN, BB, Eurostat, etj. Këto statistika janë kryesisht në formën e serive kohore me frekuencë vjetore, tremujore e mujore. Kohëzgjatja e tyre e marrë në konsideratë për ndërtimin e këtij kuadri është përgjithësisht që prej vitit 1996. Pasi janë ndjekur të gjitha etapat metodologjike të parashikimit, skenari bazë i përfutur synon të paraqesë situatën makroekonomike përgjithësisht më të mundshme, dhe maksimalisht konsistente në aspektin e një ekonomie të plotë e integrale.

Objektivat themelore të miksit të politikave fiskale e monetare përgjatë tre viteve në vijim nëpërmjet të cilave synohet ruajtja dhe konsolidimi i mëtejshëm i stabilitetit makroekonomik të vendit, krijimi i klimës për një rritje të lartë e të qëndrueshme ekonomike, si dhe konvergimi sa shpejt drejt nivelit mesatar të mirëqënies të Bashkimit Evropian, janë:

- Synimi i një trajktore rënëse të borxhit publik duke targetuar si objektiv operativ vjetor rikthimin e buxhetit në një balancë primare të balancuar ose me suficit mundësisht që prej vitit 2022, por domosdoshmërisht prej vitit buxhetor 2023 dhe në vijim. Që prej korrikut 2020 ky objektiv tashmë është sanksionuar edhe në LOB nëpërmjet përfshirjes së një rregulli të ri fiskal.
- Mbajtja e një niveli të investimeve publike mbi nivelin e deficitit të përgjithshëm fiskal në çdo vit dhe mundësisht mbi nivelin 4.5 përqind të PBB mesatarisht çdo vit.
- Ruajtja e stabilitetit të çmimeve, si objektiv themelor i politikës monetare, e cila targeton një normë inflacioni në nivelin 3 përqind dhe ankorimin e pritshmërive të tij rreth këtij niveli. Harmonizmin e politikës fiskale me këtë objektiv themelor të politikës monetare.
- Zbutja e deficitit të llogarisë korrente dhe përmirësimi i pozicionit të jashtëm të ekonomisë duke tentuar rritjen graduale të nivelit të rezervave valutore, dhe duke ruajtur të paktën një nivel dysheme të tyre, të mjaftueshëm për të financuar jo më pak se 4 muaj import mallrash dhe shërbimesh.

Këto objektiva fundamentale përbëjnë konturet bazë të këtij programi ekonomik e fiskal brenda të cilave përcaktohen projeksionet dhe programohen të gjithë variablat e tjerë makroekonomikë e fiskalë.

Skenari makroekonomik e fiskal afat-mesëm

Pas recensionit të fortë në vitin 2020, aktualisht i parashikuar në -4.4 përqind, ekonomia pritet të rekuperohet në vitin 2021 dhe të vijojë trendin pozitiv në periudhën afatmesme. Rritja ekonomike parashikohet në 5.5 përqind në vitin 2021 dhe parashikohet mesatarisht rreth 4.4 përqind në vit përgjatë periudhës afatmesme në vijim 2022-2024. Më specifikisht, rritja ekonomike parashikohet në 4.8, 4.5 dhe 3.9 përqind respektivisht për vitet 2022, 2023 dhe 2024.

Gjatë periudhës afatmesme rritja pritet të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi ashtu edhe investimet. Ndërkohë kërkesa e huaj neto (eksport – import) pritet të ketë një efekt pothuajse neutral, marxhinalisht në kahun pozitiv. Konsumi privat pritet të nxitet kryesisht nga përmirësimi i besimit të konsumatorit, si dhe nga përmirësimet në tregun e punës. Këto të fundit priten të transmetohen në një rritje graduale të pagave të cilat më tej pritet të stimulojnë të ardhurat reale të disponueshme të individëve, duke krijuar efektin e raundit të dytë në nxitjen e konsumit, si dhe duke intensifikuar prirjen e konsumatorëve për financimin e mëtejshëm të konsumit nëpërmjet një kredi-marrje më të lartë. Ndërkohë, kredimarrja për konsum parashikohet të nxitet edhe nga përmirësimi i pritshëm i kushteve financiare të individëve, ashtu edhe nga lehtësimi i pritshëm i standardeve të huadhënies nga sistemi bankar në periudhën afatmesme, pas kapërcimit të efektit negativ nga goditja e pandemisë.


Ndërsa rritja graduale e investimeve pritet të nxitet nga një shfrytëzim më i intensifikuar i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit, si dhe nga përshpejtimi i aktivitetit ekonomik gjatë periudhës së parashikuar dhe perceptimi i përmirësuar i biznesit mbi perspektivën ekonomike afatmesme e afatgjatë. Njëkohësisht edhe përmirësimi i kushteve financiare dhe lehtësimit të standardeve të huadhënies priten të jenë një faktor i rëndësishëm incentivues i investimeve private në afatin e mesëm.

Specifikisht, konsumi final total për periudhën afatmesme (2022 – 2024) parashikohet të rritet në terma real me mesatarisht rreth 3 përqind në vit, duke kontribuar me mesatarisht rreth 2.7 pikë përqindje në vit në rritjen e PBB. Ndërsa investimet totale në ekonomi parashikohen të rriten në terma real mesatarisht në rreth 6.4 përqind në vitet 2022-2024, me një kontribut mesatar në rritjen totale prej rreth 1.5 pikë përqindje në vit.

Kërkesa e huaj neto pritet të ketë efekt pothuajse neutral në periudhën afatmesme. Eksportet e mallrave të cilat zakonisht kanë patur performancë të mirë në vite, priten të vazhdojnë këtë trend pozitiv dhe të ruajnë ritmet e kaluara. Eksportet e shërbimeve, veçanërisht shërbimet turistike, priten gjithashtu të rikthejnë performancën pozitive në periudhën afatmesme dhe të jenë elementi kryesor për të kompensuar kontributin negativ të ardhur prej rritjes së importeve.

Sa i takon më specifikisht komponentëve të kërkesës së huaj neto, eksportet e mallrave dhe shërbimeve për periudhën 2022-2024, parashikohen të rriten me mesatarisht rreth 8.8 përqind në vit në terma real, me një kontribut mesatar pozitiv prej rreth 2.5 pikë përqindje në vit në rritjen e PBB. Ndërsa importet e mallrave dhe shërbimeve për këtë periudhë afatmesme parashikohen të zgjerohen me mesatarisht rreth 5.5 përqind në vit me një kontribut mesatar negativ në rritjen e PBB me rreth 2.2 pikë përqindje në vit. Rrjedhimisht, në terma neto kërkesa e huaj parashikohet të ketë një kontribut lehtësisht pozitiv, pothuajse neutral, në rritjen totale të PBB me mesatarisht rreth 0.2 pikë përqindje në vit.

Grafik: Rritja reale (majtas, në përqind) dhe kontributet në rritje (djathtas, në p.p.) sipas komponentëve të kërkesës agregate




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Megjithëse politika fiskale do të vazhdojë të jetë e orientuar drejt konsolidimit në periudhën afatmesme dhe afatgjatë, politika buxhetore e qeverisë për të ruajtur një nivel të investimeve publike në mbi 4.5 përqind të PBB në vitet 2022-2024 do të stimulojë formimin e kapitalit fiks bruto në ekonomi, esenciale kjo për të mbështetur nivele relativisht të larta rritje në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Në të njëjtën kohë, vijimi i politikës monetare akomoduese parashikuar në periudhën afatmesme, duke marrë parasysh presionet e ulta inflacioniste, do të mbështesë konsumin privat dhe investimet.

Konsolidimi fiskal i synuar nga qeveria do të kufizojë kërkesën e përgjithshme të sektorit publik. Si i tillë, nuk pritet të jetë një nxitës i rritjes në periudhën afatmesme. Megjithatë, konsolidimi fiskal do të ulë primin e riskut në periudhën afatmesme dhe do të rrisë hapësirat për stimul në sektorin privat, fundamente mjaft të rëndësishme këto për sigurimin e një rritje të lartë e të qëndrueshme. Në të njëjtën kohë, komponentët e politikave buxhetore të planifikuara do të mbështesin rritjen dhe për këtë arsye efekti shtrëngues i konsolidimit fiskal pritet të kompensohet.

Grafik: Rritja reale (majtas, në përqind) dhe kontributet në rritje (djathtas, në p.p.) sipas komponentëve të ofertës agregate




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Nga pikëpamja e ofertës agregate pritet që të gjithë sektorët kryesorë të vazhdojnë të rriten pak a shumë me të njëjtin trend të mesatares së tyre historike. Specifikisht, bujqësia pritet të rritet mesatarisht me rreth 2.5 përqind në vit në terma real përgjatë periudhës 2022-2024, me një kontribut mesatar vjetor në rritjen ekonomike prej rreth 0.5 pikë përqindje; Industria me një rritje mesatare vjetore prej rreth 5.2 përqind dhe një kontribut mesatar vjetor prej rreth 0.6 pikë përqindje; Ndërtimi me rritje mesatare vjetore prej rreth 3.5 përqind dhe kontribut mesatar vjetor prej rreth 0.3 pikë përqindje; Shërbimet me një rritje mesatare vjetore prej rreth 5.1 përqind dhe një kontribut mesatar vjetor prej rreth 2.5 pikë përqindje.

Në përputhje me parashikimet afatmesme të rritjes, punësimi pritet të rritet me një mesatare prej rreth 1.2 përqind në vit gjatë viteve 2022-2024. Shkalla më e lartë e pjesëmarrjes në forcat e punës do të jetë gjeneruesi kryesor i rritjes së ofertës së punës. Ndërsa rritja e kërkesës për punë pritet të reflektojë pak a shumë të njëjtën strukturë të perspektivës së ofertës agregate të aktivitetit ekonomik. Rrjedhimisht pritet që shërbimet të kontribuojnë më shumë në rritjen e kërkesës për punë në krahasim me sektorët e tjerë të ekonomisë. Megjithë zgjerimin e pritsëm të punësimit në afatin e mesëm, sërish produktiviteti i përgjithshëm i punës pritet të vijojë një përmirësim gradual gjatë kësaj periudhe.

Grafik: Punësimi (në të majtë, rritja vjetore në përqind) dhe norma e papunësisë (në të djathtë, në përqind)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Presionet inflacioniste parashikohet të forcohen në periudhën afatmesme. Presionet e brendshme inflacioniste priten të përshpejtohen si rezultat i rritjes së konsumit privat dhe investimeve, të cilat do të mbështesin një ritëm më të shpejtë të rritjes ekonomike. Për më tepër, parashikimi për forcimin e kërkesës agregate dhe inflacionit në mjedisin ndërkombëtar pritet të përçojnë një efekt inflacionist disi më të rritur në ekonominë shqiptare për periudhën afatmesme në vijim. Inflacioni pritet të rritet gradualisht dhe të rikthehet në objektivin e politikës monetare në afatin e mesëm.

Parashikimet për treguesit kryesorë makroekonomikë paraqiten në Lidhjen Nr.1 bashkëngjitur VKM.

Bazuar mbi parashikimet e treguesve kryesorë makroekonomik, reformave dhe ndryshimeve fiskale të ndërmarra dhe vecanësisht ato të pritshme për t'u ndërmarrë në vijim, përfshirë këtu edhe efektet e pritshme të përmirësimit administrativ, si dhe të faktorëve të tjerë përcaktues në ecurinë e zërave të ndryshëm të të ardhurave të buxhetit të shtetit, të ardhurat totale të buxhetit për tre vitet në vijim (2022 -2024) parashikohet të rriten mesatarisht me rreth 7.1 përqind në çdo vit. Më specifikisht 6.9 përqind për vitin 2022, 7.6 përqind për 2023 dhe 6.9 përqind për 2024. Të ardhurat tatimore për këtë periudhë parashikohen me një rritje mesatare vjetore prej rreth 8.1 përqind.


Grafik: Të ardhurat (majtas në miliardë Lekë, djathtas në përqind të PBB)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Duke qëndruar brenda kontureve të parashikimeve të treguesve makroekonomikë dhe të të ardhurave për tre vitet në vijim, si dhe duke synuar respektimin e objektivave të sipërpërmendur të deficitit fiskal për këtë periudhë, burimet totale të qeverisë për t'u shpenzuar gjatë viteve 2022 – 2024 pritet të jenë mesatarisht në rreth 602.1 miliard Lekë në çdo vit ose mesatarisht rreth 31.2 përqind e PBB. Investimet publike janë programuar të mbahen në një nivel mesatarisht prej rreth 4.8 përqind të PBB në çdo vit (vetëm nga qeveria qendrore, pa përfshirë ato nga qeveria lokale), i cili konsiderohet një nivel i përshtatshëm për mbështetjen e një rritje ekonomike të lartë e të qëndrueshme.

Grafik: Shpenzimet (majtas në miliardë Lekë, djathtas në përqind të PBB)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Parashikimet e të ardhurave sipas zërave të buxhetit të konsoliduar, si dhe niveli i shpenzimeve të shpërndara sipas zërave të buxhetit të konsoliduar paraqiten në Lidhjet nr.2/1 dhe Nr.2/2 bashkëngjitur VKM, respektivisht në terma nominalë dhe në raport me PBB.

Lidhja Nr. 1 – Treguesit kryesorë makroekonomikë

Treguesit	Njësia	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
						Vler.	Para.	Para.	Para.	Para.
Popullsia	Milion	2.9	2.9	2.9	2.9	2.8	2.8	2.8	2.8	2.8
Inflacioni (mesatar)	%	1.3	2.0	2.0	1.4	1.7	2.4	2.8	3.0	3.0
Deflatori i PBB	%	-0.6	1.5	1.4	0.5	-2.1	1.5	2.2	2.4	2.4
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	124.1	119.1	108.0	109.9	108.9	108.9	108.9	108.9	108.9
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	137.4	134.2	127.6	123.0	123.8	123.8	123.8	123.8	123.8
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit të Fuqisë Blerese (PPP)	Lek / USD	42.7	41.4	41.3	40.6	40.6	40.6	40.6	40.6	40.6
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit të Fuqisë Blerese (PPP)	Lek / Euro	55.6	55.6	55.7	55.7	55.7	55.7	55.7	55.7	55.7
Rritja reale e PBB	%	3.3	3.8	4.1	2.2	-4.4	5.5	4.8	4.5	3.9
PBB	Lek miliardë	1,472.5	1,550.6	1,635.7	1,679.3	1,572.3	1,682.6	1,803.0	1,928.8	2,050.8
PBB	USD miliardë	11.9	13.0	15.1	15.3	14.4	15.4	16.6	17.7	18.8
PBB	Euro miliard	10.7	11.6	12.8	13.7	12.7	13.6	14.6	15.6	16.6
PBB për banor	Lek mijë	512.0	539.6	570.7	588.4	552.0	592.0	635.9	682.2	727.6
PBB për banor	USD	4,124.0	4,531.0	5,284.4	5,356.0	5,068.1	5,435.8	5,838.9	6,263.9	6,680.8
PBB për banor	Euro	3,727.1	4,022.7	4,472.6	4,782.8	4,459.0	4,782.5	5,137.2	5,511.1	5,877.9
PBB për banor	USD-PPP	12,002.9	13,037.0	13,834.0	14,503.5	13,606.3	14,593.4	15,675.6	16,816.6	17,935.9
PBB për banor	Euro-PPP	9,206.8	9,702.9	10,240.4	10,569.5	9,915.7	10,635.0	11,423.7	12,255.2	13,070.9
Norma e papunësisë	%	15.6	14.1	13.0	12.9	12.0	11.1	10.3	9.4	8.9
Të ardhurat totale	% të PBB	27.6	27.8	27.5	27.4	27.0	28.8	28.7	28.9	29.0
Shpenzimet totale	% të PBB	29.5	29.8	29.1	29.3	33.7	35.2	31.6	31.1	31.1
Bilanci i përgjithshëm	% të PBB	-1.8	-2.0	-1.6	-1.9	-6.7	-6.5	-2.9	-2.3	-2.0
Bilanci primar fiskal	% të PBB	0.7	0.1	0.6	0.2	-4.5	-3.9	-0.1	0.6	1.1
Bilanci korrent fiskal	% të PBB	2.6	3.0	3.2	2.6	-0.6	0.7	1.9	2.5	2.8
Borxhi publik NETO nga gjendja e likuiditetit në TSA (Neto)	% të PBB	71.7	68.8	64.7	65.3	78.6	78.2	75.7	72.8	70.5
Borxhi Publik (Bruto)	% të PBB	72.4	70.2	67.7	66.3	79.9	78.6	77.7	75.6	73.8
<i>Borxhi publik i qeverise se pergjithshme</i>	% të PBB	68.7	66.9	64.9	63.7	75.1	75.4	74.9	73.1	71.6
<i>Borxhi publik jashte treguesve fiskale</i>	% të PBB	3.7	3.3	2.8	2.5	4.8	3.2	2.8	2.5	2.2
Bilanci i llogarisë korrente	% të PBB	-7.6	-7.5	-6.8	-8.0	-9.2	-7.1	-7.2	-7.1	-6.7
Bilanci tregtar (Mallra & Shërbime)	% të PBB	-16.8	-15.1	-13.7	-13.8	-15.4	-13.1	-12.7	-12.2	-11.6
Mallra	% të PBB	-24.3	-24.4	-22.4	-23.0	-21.1	-21.0	-20.3	-19.9	-19.6
Eksporte	% të PBB	6.7	6.9	7.7	6.6	6.0	6.7	7.2	7.3	7.6
Importe	% të PBB	-30.9	-31.3	-30.1	-29.7	-27.1	-27.7	-27.5	-27.3	-27.2
Bilanci i pagesave	% të PBB	0.4	1.6	2.9	-0.6	1.8	0.8	1.6	1.8	1.7
Rezervat valutore	Euro milion	2,945.0	2,995.9	3,399.0	3,359.6	3,586.3	3,701.3	3,940.8	4,216.2	4,497.3
Në muaj importi mallrash e shërbimesh	Muaj	7.2	6.7	7.0	6.5	8.6	8.0	8.0	7.9	7.9

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Banka Botërore

Lidhja Nr. 2/1 – Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar

(në milionë Lekë)

Nr.	E M È R T I M I	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
						Pritshmi	Buxhet	PBA	PBA	PBA
	TOTALI TË ARDHURAVE	407,021	430,397	449,909	460,349	424,123	484,106	517,366	556,876	595,368
I.	Ndihmat	14,639	11,085	8,164	10,609	11,700	20,353	13,994	14,958	13,957
II.	Të ardhura tatimore	369,884	398,629	419,333	426,271	392,590	442,153	480,722	519,018	558,011
II.1	Nga tatimet dhe doganat	275,780	293,386	304,318	304,758	275,560	316,172	346,380	375,495	403,993
II.2	Të ardhura nga pushteti lokal	14,951	18,447	21,863	23,102	21,942	25,426	26,632	28,353	31,631
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	79,153	86,795	93,153	98,411	95,087	100,555	107,710	115,170	122,387
III.	Të ardhura jo-tatimore	22,498	20,683	22,412	23,469	19,834	21,600	22,650	22,900	23,400
	TOTALI I SHPENZIMEVE	433,697	461,410	476,147	491,897	530,115	592,801	568,551	600,484	636,970
I.	Shpenzime Korrente	368,720	382,287	397,345	416,852	420,728	467,769	481,298	505,537	533,607
I.1	Personeli	67,540	72,642	73,582	76,962	76,650	91,834	92,173	93,273	94,906
	Paga	58,215	62,581	62,174	65,636	65,597	71,085	79,159	79,809	80,609
	Kontributi për sigurime shoqërore	9,325	10,061	10,304	10,579	10,575	11,699	11,864	12,064	12,798
	Fondi i veçantë i pagave						250	300	500	500
	Politika të reja pagash						8,000			
	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta			1,103	747	478	800	850	900	1,000
I.2	Interesat	36,259	31,904	36,513	35,143	35,060	43,800	49,534	55,822	64,081
	Të brendshme	25,526	21,415	23,158	22,838	22,610	24,300	28,511	31,189	33,758
	Të huaja	10,733	10,489	13,355	12,305	12,450	15,000	16,022	19,132	24,323
	Kontingjencë për luhatjet e normave të interesit, etj						4,500	5,000	5,500	6,000
I.3	Shpenzime operative e mirëmbajtje	44,329	43,441	45,498	47,215	49,312	49,888	51,448	55,648	57,715
	Të qeverisjes qendrore (operative & mirëmbajtje)					46,218	46,538	47,948	52,148	54,115
	Arsimi i lartë					900	800	900	900	1,000
	Të tjera jashtë limitit					2,194	2,550	2,600	2,600	2,600
I.4	Subvencionet	1,725	2,310	1,883	1,421	1,540	1,550	1,500	1,500	1,550
I.5	Shpenzime për fondet speciale	152,591	162,146	168,249	175,628	178,500	195,171	202,771	211,691	222,124
	Sigurime shoqërore	114,276	119,081	125,364	131,238	133,744	142,265	149,065	156,565	165,298
	Politika të reja pensionesh						2,400	2,500	3,020	3,453
	Sigurime shëndetësore	34,796	39,090	40,154	42,118	42,856	47,506	46,206	46,606	47,873
	Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve	3,519	3,974	2,731	2,272	1,900	3,000	5,000	5,500	5,500
I.6	Buxheti lokal	43,580	46,487	49,615	56,227	51,382	56,826	58,072	61,103	66,131
	Granti nga Buxheti i Shtetit per pushtetin vendor	28,629	28,039	27,753	33,124	25,040	27,050	26,750	28,000	29,500
	Fond i pakushtezuar					17,200	18,450	18,200	19,300	20,500
	Grant Specifik					7,840	8,100	8,000	8,100	8,200
	Transferte per emergjencat civile						500	550	600	800
	Buxheti lokal (të ardhurat e veta tatimore)	14,951	18,447	21,863	23,102	21,942	25,426	26,632	28,353	31,631
	Taksa të ndara					600	900	900	900	900
	Buxheti lokal (të ardhurat e veta jo-tatimore)					2,800	2,700	2,840	2,900	3,100
	Financimi i huaj vendor dhe te tjera te mbartura					1,000	750	950	950	1,000
I.7	Transferta të tjera	22,696	23,357	22,004	24,257	28,283	28,700	25,800	26,500	27,100
	Pagesa e papunësisë	691	346	336	505	868	800	600	600	600
	Ndihma ekonomike	20,026	20,714	20,671	20,189	23,535	24,700	21,900	22,200	22,700
	Kompensim për të përndjekurit politikë	1,979	2,298	997	1,199	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000
	Bonusi i lindjeve				2,364	2,880	2,200	2,300	2,700	2,800
II.	Fondi rezervë					12,050	4,000	1,500	3,500	4,000
	Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave						3,000	1,500	2,500	4,000
	Kosto e zgjedhjeve						1,000		1,000	
	Paketa e mbështetjes sociale nga COVID					12,050				
III.	Shpenzime kapitale	59,478	68,455	78,434	74,993	97,337	121,032	86,153	91,447	99,363
	Financimi i brendshëm	39,118	46,177	51,552	50,641	48,153	57,604	45,041	57,787	61,363
	Arsim i lartë nga të ardhurat e veta			672	890	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000
	Financimi i huaj	20,360	22,278	26,210	23,462	27,184	34,428	30,112	32,660	37,000
	Nga te cilat: energjia				1,313	1,000	2,300	2,100	2,000	2,000
	Fondi i ri-ndërtimit pas tërmetit:					21,000	28,000	10,000		
	Fondi i ri-ndërtimit pas tërmetit (buxheti i shtetit)					18,000	28,000	10,000		
	Fondi i ri-ndërtimit pas tërmetit (Grant)					3,000				
	Fondi i ri-ndërtimit pas tërmetit (Kredi)									
IV.	Detyrimet e prapambetura									
V.	Të tjera	5,499	9,217	368	53					
VI.	Fond shpronësimi		1,450							
	DEFIÇITI	-26,676	-31,012	-26,238	-31,549	-105,992	-108,695	-51,585	-43,608	-41,602
	FINANCIMI DEFIÇITIT	26,676	31,012	26,238	31,549	105,992	108,695	51,585	43,608	41,602
I.	I brendshëm	9,176	1,899	-6,866	40,932	45,432	70,077	-235	8,201	4,703
	Të ardhura nga privatizimi	2,805	418	104	242					
	Hua-marrje e brendshme (neto)	10,602	16,285	19,591	17,846	49,400	49,900	30,000	25,000	20,000
	Të tjera, nga të cilat:	-4,231	-14,804	-26,561	22,844	-3,968	20,177	-30,235	-16,799	-15,297
	Ndryshimi i gjendjes së likuiditetit në TSA	298	-10,962	-30,533	16,624	-3,968	14,177	-30,235	-16,799	-15,297
	Ndryshimi i gjendjes se depozites sig. Shoq&Shend						6,000			
II.	I huaj	17,500	29,113	33,104	-9,383	60,560	38,618	51,820	35,407	36,899
	Hua afatgjatë (e marrë)	18,780	23,407	83,761	20,493	100,641	24,178	81,952	83,500	87,890
	Per projekte	18,780	23,407	21,232	20,493	19,184	23,428	19,112	20,660	25,000
	Per ri-ndertimin nga termeti									
	Eurobond			62,529		80,457		61,890	61,890	61,890
	Nen-hua (Pushtet vendor)					1,000	750	950	950	1,000
	Ndryshimi i gjendjes së arkës	-408	169	106	-1,729					
	Ripagesat, nga te cilat:	-21,998	-25,769	-51,678	-29,791	-62,745	-40,890	-42,510	-48,093	-50,991
	Eurobond			-25,012		-30,945				
	Maturim					-30,945				
	Para-blerje			-25,012						
	Mbështetje buxhetore (hua nga FMN, BB, BE, etj)	21,126	31,306	916	1,643	22,664	55,330	12,378		
	MEMO:									
	Balanca e përgjithshme (deficiti përgjithshëm)	-26,676	-31,012	-26,238	-31,549	-105,992	-108,695	-51,585	-43,608	-41,602
	Balanca korente	38,301	46,660	52,197	43,444	-8,655	12,337	34,568	47,839	57,761
	Balanca primare	9,583	891	10,276	3,594	-70,932	-64,895	-2,052	12,214	22,478
	Gjendja e likuiditetit në TSA (stok)	10,464	21,904	49,440	16,176	20,144	5,967	36,202	53,001	68,297
	Borxhi publik NETO nga gjendja e likuiditetit në TSA	1,056,146	1,066,265	1,057,845	1,096,450	1,235,398	1,315,939	1,364,375	1,405,160	1,445,159
	Borxhi publik BRUTO (stok)	1,066,610	1,088,169	1,107,285	1,112,626	1,255,542	1,321,906	1,400,576	1,458,161	1,513,456
	Borxhi publik nga buxheti (stok)	1,012,241	1,037,457	1,061,897	1,070,191	1,180,152	1,268,669	1,350,489	1,410,896	1,467,795
	I brendshëm (stok)	530,834	546,939	565,093	582,136	631,536	681,436	711,436	736,436	756,436
	I huaj (stok)	481,407	490,518	496,804	488,056	548,616	587,234	639,054	674,460	711,359
	Borxhi publik jashtë buxhetit (stok)	54,369	50,712	45,388	42,435	75,390	53,237	50,087	47,265	45,661
	Pushtet vendor (stok)	901	827	716	582	750	800	850	900	900
	Borxhi publik i garantuar (stok)	53,468	49,885	44,672	41,853	74,640	52,437	49,237	46,365	44,761
	PBB nominal	1,472,480	1,550,644	1,635,715	1,679,284	1,572,269				

Nr.	E M Ë R T I M I	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
						Pritshmi	Buxhet	PBA	PBA	PBA
	TOTALI TË ARDHURAVE	27.6	27.8	27.5	27.4	27.0	28.8	28.7	28.9	29.0
I.	Ndihmat	1.0	0.7	0.5	0.6	0.7	1.2	0.8	0.8	0.7
II.	Të ardhura tatimore	25.1	25.7	25.6	25.4	25.0	26.3	26.7	26.9	27.2
II.1	<i>Nga tatimet dhe doganat</i>	<i>18.7</i>	<i>18.9</i>	<i>18.6</i>	<i>18.1</i>	<i>17.5</i>	<i>18.8</i>	<i>19.2</i>	<i>19.5</i>	<i>19.7</i>
II.2	<i>Të ardhura nga pushteti lokal</i>	<i>1.0</i>	<i>1.2</i>	<i>1.3</i>	<i>1.4</i>	<i>1.4</i>	<i>1.5</i>	<i>1.5</i>	<i>1.5</i>	<i>1.5</i>
II.3	<i>Të ardhura nga fondet speciale</i>	<i>5.4</i>	<i>5.6</i>	<i>5.7</i>	<i>5.9</i>	<i>6.0</i>	<i>6.0</i>	<i>6.0</i>	<i>6.0</i>	<i>6.0</i>
III.	Të ardhura jo-tatimore	1.5	1.3	1.4	1.4	1.3	1.3	1.3	1.2	1.1
	TOTALI I SHPENZIMEVE	29.5	29.8	29.1	29.3	33.7	35.2	31.6	31.1	31.1
I.	Shpenzime Korrente	25.0	24.7	24.3	24.8	26.8	27.8	26.7	26.2	26.0
I.1	Personeli	4.6	4.7	4.5	4.6	4.9	5.5	5.1	4.8	4.6
	<i>Paga</i>	<i>4.0</i>	<i>4.0</i>	<i>3.8</i>	<i>3.9</i>	<i>4.2</i>	<i>4.2</i>	<i>4.4</i>	<i>4.1</i>	<i>3.9</i>
	<i>Kontributi për sigurime shoqërore</i>	<i>0.6</i>	<i>0.6</i>	<i>0.6</i>	<i>0.6</i>	<i>0.7</i>	<i>0.7</i>	<i>0.7</i>	<i>0.6</i>	<i>0.6</i>
	<i>Fondi i veçantë i pagave</i>						0.0	0.0	0.0	0.0
	<i>Politika të reja pagash</i>						0.5			
	<i>Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta</i>			0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
I.2	Interesat	2.5	2.1	2.2	2.1	2.2	2.6	2.7	2.9	3.1
	<i>Të brendshme</i>	<i>1.7</i>	<i>1.4</i>	<i>1.4</i>	<i>1.4</i>	<i>1.4</i>	<i>1.4</i>	<i>1.6</i>	<i>1.6</i>	<i>1.6</i>
	<i>Të huaja</i>	<i>0.7</i>	<i>0.7</i>	<i>0.8</i>	<i>0.7</i>	<i>0.8</i>	<i>0.9</i>	<i>0.9</i>	<i>1.0</i>	<i>1.2</i>
	<i>Kontigjencë për luhatjet e normave të interesit, etj</i>						0.3	0.3	0.3	0.3
I.3	Shpenzime operative e mirëmbajtje	3.0	2.8	2.8	2.8	3.1	3.0	2.9	2.9	2.8
	<i>Të qeverisjes qendrore (operative & mirëmbajtje)</i>					2.9	2.8	2.7	2.7	2.6
	<i>Arsimi i lartë</i>					0.1	0.0	0.0	0.0	0.0
	<i>Të tjera jashtë limitit</i>					0.1	0.2	0.1	0.1	0.1
I.4	Subvencionet	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
I.5	Shpenzime për fondet speciale	10.4	10.5	10.3	10.5	11.4	11.6	11.2	11.0	10.8
	<i>Sigurime shoqërore</i>	<i>7.8</i>	<i>7.7</i>	<i>7.7</i>	<i>7.8</i>	<i>8.5</i>	<i>8.5</i>	<i>8.3</i>	<i>8.1</i>	<i>8.1</i>
	<i>Politika të reja pensionesh</i>						0.1	0.1	0.2	0.2
	<i>Sigurime shëndetësore</i>	<i>2.4</i>	<i>2.5</i>	<i>2.5</i>	<i>2.5</i>	<i>2.7</i>	<i>2.8</i>	<i>2.6</i>	<i>2.4</i>	<i>2.3</i>
	<i>Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve</i>	<i>0.2</i>	<i>0.3</i>	<i>0.2</i>	<i>0.1</i>	<i>0.1</i>	<i>0.2</i>	<i>0.3</i>	<i>0.3</i>	<i>0.3</i>
I.6	Buxheti lokal	3.0	3.0	3.0	3.3	3.3	3.4	3.2	3.2	3.2
	<i>Granti nga Buxheti i Shtetit per pushtetin vendor</i>	<i>1.9</i>	<i>1.8</i>	<i>1.7</i>	<i>2.0</i>	<i>1.6</i>	<i>1.6</i>	<i>1.5</i>	<i>1.5</i>	<i>1.4</i>
	<i>Fond i pakushtezuar</i>					1.1	1.1	1.0	1.0	1.0
	<i>Grant Specifik</i>					0.5	0.5	0.4	0.4	0.4
	<i>Transferte per emergjencat civile</i>						0.0	0.0	0.0	0.0
	<i>Buxheti lokal (të ardhurat e veta tatimore)</i>	<i>1.0</i>	<i>1.2</i>	<i>1.3</i>	<i>1.4</i>	<i>1.4</i>	<i>1.5</i>	<i>1.5</i>	<i>1.5</i>	<i>1.5</i>
	<i>Taksa të ndara</i>					0.0	0.1	0.0	0.0	0.0
	<i>Buxheti lokal (të ardhurat e veta jo-tatimore)</i>					0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
	<i>Financimi i huaj vendor dhe te tjera te mbartura</i>					0.1	0.0	0.1	0.0	0.0
I.7	Transferta të tjera	1.5	1.5	1.3	1.4	1.8	1.7	1.4	1.4	1.3
	<i>Pagesa e papunësisë</i>	<i>0.0</i>	<i>0.0</i>	<i>0.0</i>	<i>0.0</i>	<i>0.1</i>	<i>0.0</i>	<i>0.0</i>	<i>0.0</i>	<i>0.0</i>
	<i>Ndihma ekonomike</i>	<i>1.4</i>	<i>1.3</i>	<i>1.3</i>	<i>1.2</i>	<i>1.5</i>	<i>1.5</i>	<i>1.2</i>	<i>1.2</i>	<i>1.1</i>
	<i>Kompensim për të përndjekurit politikë</i>	<i>0.1</i>	<i>0.1</i>	<i>0.1</i>	<i>0.1</i>	<i>0.1</i>	<i>0.1</i>	<i>0.1</i>	<i>0.1</i>	<i>0.0</i>
	<i>Bonusi i lindjeve</i>				0.1	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1
II.	Fondi rezervë					0.8	0.2	0.1	0.2	0.2
	<i>Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave</i>						0.2	0.1	0.1	0.2
	<i>Kosto e zgjedhjeve</i>						0.1		0.1	
	<i>Paketa e mbeshtetjes sociale nga COVID</i>					0.8				
III.	Shpenzime kapitale	4.0	4.4	4.8	4.5	6.2	7.2	4.8	4.7	4.8
	<i>Financimi i brendshëm</i>	<i>2.7</i>	<i>3.0</i>	<i>3.2</i>	<i>3.0</i>	<i>3.1</i>	<i>3.4</i>	<i>2.5</i>	<i>3.0</i>	<i>3.0</i>
	<i>Arsim i lartë nga të ardhurat e veta</i>			0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.0
	<i>Financimi i huaj</i>	<i>1.4</i>	<i>1.4</i>	<i>1.6</i>	<i>1.4</i>	<i>1.7</i>	<i>2.0</i>	<i>1.7</i>	<i>1.7</i>	<i>1.8</i>
	<i>Nga te cilat: energjia</i>	<i>0.0</i>	<i>0.0</i>	<i>0.0</i>	<i>0.1</i>	<i>0.1</i>	<i>0.1</i>	<i>0.1</i>	<i>0.1</i>	<i>0.1</i>
	<i>Fondi i ri-ndërtimit pas tërmetit:</i>					1.3	1.7	0.6		
	<i>Fondi i ri-ndërtimit pas tërmetit (buxheti i shtetit)</i>					1.1	1.7	0.6		
	<i>Fondi i ri-ndërtimit pas tërmetit (Grant)</i>					0.2				
	<i>Fondi i ri-ndërtimit pas tërmetit (Kredi)</i>									
IV.	Detyrimet e prapambetura									
V.	Të tjera	0.4	0.6	0.0	0.0					
VI.	Fond shpronësimi		0.1							
	DEFIÇITI	-1.8	-2.0	-1.6	-1.9	-6.7	-6.5	-2.9	-2.3	-2.0
	FINANCIMI DEFIÇITIT	1.8	2.0	1.6	1.9	6.7	6.5	2.9	2.3	2.0
I.	I brendshëm	0.6	0.1	-0.4	2.4	2.9	4.2	0.0	0.4	0.2
	<i>Të ardhura nga privatizimi</i>	<i>0.2</i>	<i>0.0</i>	<i>0.0</i>	<i>0.0</i>					
	<i>Hua-marrje e brendshme (neto)</i>	<i>0.7</i>	<i>1.1</i>	<i>1.2</i>	<i>1.1</i>	<i>3.1</i>	<i>3.0</i>	<i>1.7</i>	<i>1.3</i>	<i>1.0</i>
	<i>Të tjera, nga te cilat:</i>	<i>-0.3</i>	<i>-1.0</i>	<i>-1.6</i>	<i>1.4</i>	<i>-0.3</i>	<i>1.2</i>	<i>-1.7</i>	<i>-0.9</i>	<i>-0.7</i>
	<i>Ndryshimi i gjendjes së likuiditetit në TSA</i>	<i>0.0</i>	<i>-0.7</i>	<i>-1.9</i>	<i>1.0</i>	<i>-0.3</i>	<i>0.8</i>	<i>-1.7</i>	<i>-0.9</i>	<i>-0.7</i>
	<i>Ndryshimi i gjendjes se depozites sig. Shoq&Shend</i>						0.4			
II.	I huaj	1.2	1.9	2.0	-0.6	3.9	2.3	2.9	1.8	1.8
	<i>Hua afatgjatë (e marrë)</i>	<i>1.3</i>	<i>1.5</i>	<i>5.1</i>	<i>1.2</i>	<i>6.4</i>	<i>1.4</i>	<i>4.5</i>	<i>4.3</i>	<i>4.3</i>
	<i>Per projekte</i>			1.3	1.2	1.2	1.4	1.1	1.1	1.2
	<i>Per ri-ndertimin nga termeti</i>									
	<i>Eurobond</i>			3.8		5.1		3.4	3.2	3.0
	<i>Nen-hua (Pushteti vendor)</i>						0.0	0.1	0.0	0.0
	<i>Ndryshimi i gjendjes së arkës</i>	<i>0.0</i>	<i>0.0</i>	<i>0.0</i>	<i>-0.1</i>					
	<i>Ripagesat, nga te cilat:</i>	<i>-1.5</i>	<i>-1.7</i>	<i>-3.2</i>	<i>-1.8</i>	<i>-4.0</i>	<i>-2.4</i>	<i>-2.4</i>	<i>-2.5</i>	<i>-2.5</i>
	<i>Eurobond</i>			-1.5	0.0	-2.0				
	<i>Maturim</i>					-2.0				
	<i>Para-blerje</i>			-1.5						
	<i>Mbështetje buxhetore (hua nga FMN, BB, BE, etj)</i>	<i>1.4</i>	<i>2.0</i>	<i>0.1</i>	<i>0.1</i>	<i>1.4</i>	<i>3.3</i>	<i>0.7</i>		
	MEMO:									
	Balanca e përgjithshme (deficiti përgjithshëm)	-1.8	-2.0	-1.6	-1.9	-6.7	-6.5	-2.9	-2.3	-2.0
	Balanca korente	2.6	3.0	3.2	2.6	-0.6	0.7	1.9	2.5	2.8
	Balanca primare	0.7	0.1	0.6	0.2	-4.5	-3.9	-0.1	0.6	1.1
	Gjendja e likuiditetit në TSA (stok)	0.7	1.4	3.0	1.0	1.3	0.4	2.0	2.7	3.3
	Borxhi publik NETO nga gjendja e likuiditetit në T	71.7	68.8	64.7	65.3	78.6	78.2	75.7	72.8	70.5
	Borxhi publik BRUTO (stok)	72.4	70.2	67.7	66.3	79.9	78.6	77.7	75.6	73.8
	<i>Borxhi publik nga buxheti (stok)</i>	<i>68.7</i>	<i>66.9</i>	<i>64.9</i>	<i>63.7</i>	<i>75.1</i>	<i>75.4</i>	<i>74.9</i>	<i>73.1</i>	<i>71.6</i>
	<i>I brendshëm (stok)</i>	<i>36.1</i>	<i>35.3</i>	<i>34.5</i>	<i>34.7</i>	<i>40.2</i>	<i>40.5</i>	<i>39.5</i>	<i>38.2</i>	<i>36.9</i>
	<i>I huaj (stok)</i>	<i>32.7</i>	<i>31.6</i>	<i>30.4</i>	<i>29.1</i>	<i>34.9</i>	<i>34.9</i>	<i>35.4</i>	<i>35.0</i>	<i>34.7</i>
	<i>Borxhi publik jashtë buxhetit (stok)</i>	<i>3.7</i>	<i>3.3</i>	<i>2.8</i>	<i>2.5</i>	<i>4.8</i>	<i>3.2</i>	<i>2.8</i>	<i>2.5</i>	<i>2.2</i>
	<i>Pushteti vendor (stok)</i>	<i>0.1</i>	<i>0.1</i>	<i>0.0</i>	<i>0.0</i>	<i>0.0</i>	<i>0.0</i>	<i>0.0</i>	<i>0.0</i>	<i>0.0</i>
	<i>Borxhi publik i garantuar (stok)</i>	<i>3.6</i>	<i>3.2</i>	<i>2.7</i>	<i>2.5</i>	<i>4.7</i>	<i>3.1</i>	<i>2.7</i>	<i>2.4</i>	<i>2.2</i>
	PBB nominal	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0